



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 38, datë 18.04.2025

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“GODINË BANIMI 1-6 KATE MBI TOKË ME 1-3 KATE NËNTOKË”, ME
VENDNDODHJE NË BASHKINË HIMARË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Duni Group Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Godinë banimi 1-6 kate mbi tokë me 1-3 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Duni Group Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturate dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 06/02/2026